



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
SHKOLLA E MAGJISTRATURËS
KËSHILLI DREJTUES**

Nr. 1685/prot.
1

Tiranë, më 30.12.2024

VENDIM QARKULLUES

Nr. 49, datë 30.12.2024

PËR

**PUBLIKIMIN E LISTËS SË KANDIDATËVE PËR PROKURORË 2024-2025, TË CILËT
KANË KALUAR PROCEDURËN E VERIFIKIMIT TË PASURISË DHE FIGURËS NGA
KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË**

Pas verifikimit të pasurisë dhe figurës dhe pas miratimit të listës së kandidatëve magistratë që pranohen në Shkollën e Magjistraturës në formimin fillestar trevjeçar, në përputhje me numrin e kandidatëve të përcaktuar nga ana e Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe Këshillit të Lartë të Prokurorisë, në zbatim të nenit 248, 266 të ligjit nr.115/2016, "Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë", të nenit 53 të ligjit nr. 98/2016, "Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë", vendimit nr. 300, datë 26.12.2024 të Këshillit të Lartë të Prokurorisë, si dhe të Rregullores së Brendshme të Shkollës së Magjistraturës, Këshilli Drejtues i Shkollës së Magjistraturës, më datë 30.12.2024,

VENDOSI:

1. Të publikojë listën e kandidatëve për magistratë, profili prokuror, për vitin akademik 2024-2025, të cilët kanë kaluar me sukses procedurën e verifikimit të pasurisë dhe figurës nga Këshilli i Lartë i Prokurorisë, sipas listës bashkëngjitur pjesë e pandarë e këtij vendimi.
2. Ngarkohet Shkolla e Magjistraturës për zbatimin e këtij vendimi.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.